



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.332/2016

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari, Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditeses; nga Mitrovica Rr.” pn.te cilen e perfaqeson me autorizim Av ne Mitrovice ,kunder te paditures; Komuna e Mitrovices- te cilen e perfaqeson UD.i ,dhe; ne Mitrovice te cilen e pertaqson I autorizuari sipas autorizimit me shkrim per shkak; te kompenzimit te ardhurave ne emer te shperblimit jubilar dhe kompenzimit ne emer te pagave percjellese per pension,pas mbajtjes se seances se shqyrtimit kryesor me dt 19.12.2017 me dt 26.01.2018 jep;

A K T G J Y K I M

I .DETYROHET e paditura

Mitrovice dhe **Obligohet** e paditura qe ne emer te pageses se pagave per shperblim jubilar pas pensionimit per periudhen e punes prej me teper se 35 vjete si Mitrovice te e paditura ,shuma prej 1282.26 euro dhe ne emer te 3 pagave percjellese per pension shuma prej 1282.26 euro ,respektivisht ,ne emer te 6 pagave shuma totale prej **2564.52 euro.cent (Dymije e pesqind e gjashdhjet e kater euro e pesdhjet e dy cent)**.me kamat sipas lartesis qe paguhet per nji vit ne bankat afariste per mjetet e depozituar pa destinim te caktuar ,duke filluar nga data e parashtrimit te padise,dt.14.06.2016 e gjer ne permbushjen definitive te detyrimit,te gjitha ne afat prej 7 dite nga dita e marrjes se aktgjykimit nen kercnim te permbarimit ligjor.

II. OBLIGOHET e paditura t'ia paguajn paditeses shpenzimet e procedures kontestimore ne shum prej 289,00 Euro,te gjitha ne afat prej 7 ditesh nga dita e marrjes se aktgjykimit nen kercnim te permbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditsja ka ushtruar padi per kompenzimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe ate ne emer te shperblimit jubilar 3paga dhe ne emer te 3 pagave percjelles per ne pension. I autorizuari I paditises ne seancen e shqyrtimit kryesor mbeti ne tersi pran padise dhe kerkespadise.

Ne fjalen perfundimtare propozoj qe gjykata ta aprovoj si te bazuar kerkespadine,

.Shpenzimet e procedures kontestimore. I kerkoj.

Perfaqesuesi I te paditures se pare ne pergjigje ne padise dhe kerkespadise se paditises deklarone kontestoj padine dhe kerkespadine e paditises si ta pa bazuar ,konsideroj se e njejta ndaj te paditures se pare eshte drejtuar gabimisht dhe ne rastin konkret I mungon legjitimiteti nga se e paditura gjegjesisht te paditurat nuk kan kurfar marveshje ne mes veti e cila do te obligonte ne kete drejtim qe te njejtat te obligohen per kerkesen qe iu eshte drejtuar nga paditsja. Te paditurat qe te dyja financohen nga niveli qendror ,prandaj padia eshte dashur qe te u drejtohet organeve qendrore.

Perfaqesuesi I te paditures se dyte ne pergjigje ne padi dhe kerkespadi deklarone: E paditura e dyte nuk munde te bene pagesa me rastin e pensionimit pa nji vendim te nivelit qendror dhe nga ky shkak prapsojm bazen ligjore per pagesen ne fjale.

Ne fjalen perfundimtare I propozojn gjykates qe kerkespadin ta refuzoj si te pabazuar

.Shpenzimet e procedures perfaqesuesi I te paditures se pare nuk I kerkoj. Ndersa I autorizuari I te paditures se dyte shpenzimet I kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme ne kuptim te nenit 7 dhe 8, te LPK, dhe erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv


Gjykata ne procedure e provave :Lexohet vendimi I te paditures se pare nr. 1000/1000/1000 dt.01.04.2016 mbi nderprerjen e kontrates se punes sipas fuqise ligjore.

Ne mes palve ndergjyqese nuk eshte kontestuese fakti se paditsja ishte ne mardhenje pune dhe se te njejtes me dt 01.04 2016 I eshte nderprer marrdhenja e punes per shkak te plotsimit te kushteve per pensionimin e saje..

Nuk eshte kontestuese se paditsja ka punuar te e paditura nga dt.01.07.1975 deri me dt.10.04.2016 si moter medicionale respektivisht mardhenja e punes pa nderpre me teper se 35 vite.dhe se ka pasur koeficientin 4,8.

Nuk eshte kontestuese fakti se lartesia e pages neto qe paditsja e ka realizuar tek e paditura para pensionit eshte shuma mujore prej 427.42 euro.

Gjykata kur vendosi sipas pikes 1 te dispozitivit sa I perket pagave per shperblim jubilar iu referee edhe nenit 52 par 1 nenpar 1.3 te Marveshjes se pergjitheshme kolektive ted t.18.03.2014 me te cilen parashihej se "Punemarrsi I cili per 30 vjet radhazi dhe panderprere te perveses se



punes te punedhënsi I fundit ti njihet e drejta ne shperblim jubilar ne vlere te tri pagave mujore te tij” Ndersa gjykata me rastin e vendosjes ne emer te kompensimit per pagesen e tri pagave percjellese per pension u bazue ne nenin 53 te marveshjes kolektive me te cilen parashihet e drejta e punemarrsit paditsit me pagesen percjellese te tri pagave mujore qe I ka marre ne tre muajt e fundit.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe prapsimet e te paditurave dhe sit e tilla I konsideron sit e pabazuara nga se e paditura I ka legjitmimin pasiv ne ket qeshtje tani lendore ne kuptim te nen.73.1 te LPK, nga se e njejta ka cilsin e personit juridik dhe eshte financuese e QKMF-se, dhe se eshte qeshtje e te paditurave - menyra e rregullimi te raporteve te financimit te tyre.

Gjithashtu eshte I pabazuar pretendimi se ne Ligjin e Punes nuk jane parapa kompensime te tilla, per arsye se nenshkruese e kesaj kontrate eshte edhe Ministria e Shendetesis prandaj kto marrveshje- kontra kane qene ne fuqi ne momentin e pensionimit dhe se te njejtat jane ne pajtushmeri te plote me nen. 90 te Ligjit te Punes nga rrjedhe themelsia e kerkespadise, prandaje u, vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me perllogaritjen e komates , u bazue ne nenin 378 par.1 te LMD-se, ndersa lartesine e saj e caktoi mbi bazen e lartesis se kamates qe paguhet ne mjetet e afatizuara ne bankat afariste per nji vit pa destinim te caktuar.

Vendimin qe pala e paditur t’I barte shpenzimet e procedures kontestimore , gjykata e ka mbshtet ne dispozitat ligjore conform nenit 449 dhe 452.1 te LPK duke I njohur paditeses shpenzimet per perpilimin e padise Shumen prej 104,00 Euro, per perfaqsim nga ana e te autorizuarit te saje ne nje seanc Shumen prej 135,00 Eur, sipas nen 7 te T.A, si dhe taxat per padi dhe vendim gjyqsor shumen prej 30,00 Euro, sipas nen 10.1 te Ttarifes mbi taks0at gjyqsore.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.332/2016 data 26.01.2018

GJYQTARI
Ragip Kadriu

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditesh, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi, Gjykates se Apejit te Kosoves ,ankesa ushtrohet perms kesaj Gjykate.

*Te 27.1.18
177-02/18*

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

SHËM
GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

Me
Dana

21.02.2018